

Nëntor 2022

# PLANI AKSIONAR VJETOR PËR VITIN 2023 PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR



Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

## PËRMBAJTJA

1	Hyrje	3
2	Përshkrimi i metodologjisë së zbatuar	4
3	Qëllimet strategjike, prioritetet dhe masat	4
4	Prioretizimi	5
5	Plani financiar i qëllimeve, prioriteteve dhe masave strategjike	6
6	Modelet e inter-aksionit mes aktorëve në realizimin e programit	6
7	Mënyra e informimit të publikut	7
8	Analiza e rrezikut	8
9	Tabela 1 – Paraqitja tabelore e aktiviteteve të projektit sipas qëllimeve, prioriteteve dhe masave strategjike,	9
10	Tabela 2 – Mjetet e nevojshme për realizim	21



Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, neni 22, paragrafi 1, alineja 3, dhe neni 30, paragrafi 1, alineja 2, nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (“Gazeta zyrtare e RMV” nr.24/21 dhe 174/21), neni 30 nga Rregullorja për metodologji për përgatitje të dokumenteve planore për zhvillim rajonal (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 219/21) dhe neni 2, paragrafi 1, alineja 3 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor nr.01-99/1 e datës 22.07.2021, Këshilli në mbledhjen e mbajtur në datë **24.11.2022** e shqyrtoi dhe e miratoi këtë:

**PROPOZIM-PLAN AKSIONAR VJETOR PËR VITIN 2023  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË  
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR**

## 1. HYRJE

Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor bazohet në parimet kryesore të përcaktuara në dokumente strategjike nacionale, rajonale dhe në nivel lokal. Gjatë kësaj, angazhimet e institucionit dalin dhe janë të lidhura me realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Në këtë dokument bazik për zhvillim të rajonit për periudhën 2021-2026 janë përcaktuar qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat, me çka përmes këtij Plani aksionar, përmes realizimit të projekteve, rritet niveli i vetë realizimit të Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Baza për përgatitjen e Planit aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është e përcaktuar në nenin 14 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (Gaz.Zyrtare 24/2021 dhe 174/2021), i cili parasheh sjelljen e Planeve aksionare vjetore për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit.

Vetë përmbajtja e Planit aksionar është e rregulluar me Rregulloren për Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve planore për zhvillim rajonal (Gaz.Zyrtare nr.219/2021). Neni 30 i kësaj Metodologjie i cili ka të bëjë me Realizimin e programit për zhvillim i përcakton elementet që duhet t'i përmbajë Plani aksionar. Gjatë përgatitjes së Planit aksionar mbahet llogari për buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

Në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, alineja 2 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, Qendra për zhvillim të rajonit planor përgatit Propozim-Plan aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor. Në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, alineja 3 nga Ligji për ZHBR, Këshilli për zhvillim të rajonit planor miraton Planin aksionar vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor.

Në këtë dokument janë paraqitur dhe projektet rajonale të cilat Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor i dorëzoi deri te BZHR për vitin 2022/2023 dhe për të cilat janë nënshkruar Marrëveshje për realizim në nëntor të 2022. Gjithashtu janë bartur edhe dy aktivitete projektuese për Komunat e Kërçovës dhe Dibrës të cilat financohen nga Programi për ZHBR 2021-2022.

Në këtë plan aksionar janë përfshirë edhe aktivitetet e komunave në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor të cilat financohen përmes Programit për ZHBR 2022-2023 – zhvillimi i fshatrave, zhvillimi i zonave urbane, zhvillimin e krahinave me nevoja të veçanta zhvillimore dhe përmes Programit për tejkalimin e dispariteteve dhe konkurrencës 2022.

Gjithashtu janë paraqitur edhe projekte të cilat financohen nga ana e Ministrisë për bujqësi, pylltarisë dhe ujërave dhe Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, për të cilat pritet thirrje për propozim projekte gjate vitit 2022 dhe 2023.

Pjesë përbërëse e këtij dokumenti janë edhe aktivitetet që do të financohen nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Ministrinë për vetëqeverisje lokale përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, - faza e II e realizimit. Përkatësisht, në kuadër të këtij projekti janë paraparë më shumë aktivitete për mbështetje të Qendrës për zhvillim dhe Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, si dhe Shema e Grantit për projekte investuese me komponentë digjitale.

Për Biznes Qendrën në kuadër të Qendrës për zhvillim të RPJP është siguruar kofinancim nga ana e SDC për organizimin e eventeve, punëtorive, programe me vauçerë përmes FIZHT, promovime dhe trajnime për biznes sektorin.

## **2. PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË SË ZBATUAR**

Për përgatitjen e Planit aksionar është shfrytëzuar metodologjia në pajtim me Rregulloren për përgatitjen e dokumenteve planore (Gaz.Zyrtare 219/21). Gjatë kësaj aktivitetet janë ndarë sipas qëllimeve strategjike, prioriteteve dhe masave nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026. Të gjitha aktivitetet janë paraqitur në mënyrë tabelore (Tabela 1) dhe për secilën nga ato është shënuar projekti, aktiviteti, korniza kohore, mjetet financiare të nevojshme, treguesit, partnerët për realizim dhe burimet e financimit. Është paraqitur edhe perspektiva gjinore.

Metodologjia e përgatitjes së Planit aksionar, e vendos në baza të mira raportin e palëve të interesuara të rajonit në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse përmes pjesëmarrjes së tyre të drejtpërdrejtë dhe kontributit në procesin e përgatitjes, por gjithashtu edhe në procesin e realizimit.

## **3. QËLLIMET, PRIORITETET DHE MASAT STRATEGJIKE**

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026 është e bazuar në konceptin bazë të politikës për zhvillim rajonal: zhvillimin dhe realizimin e modelit policentrik të zhvillimit dhe nisjet nga drejtimet e zhvillimit të rajoneve të përshkuara në Strategjinë nacionale për zhvillim të barabartë rajonal 2021-2031 si dhe nga qëllimet zhvillimore dhe prioritetet e komunave në kuadër të rajonit. Në pajtim me rregullativën ligjore, Plani aksionar është i paraqitur në formë tabelore (Tabela 1) dhe është në pajtim me qëllimet strategjike (QS), prioritetet dhe masat nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026, dhe të njëjtat janë listuar më poshtë.

**QA1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural.**

### **Prioritetet:**

- 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale
- 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM-ve
- 1.3 Rritja e investimeve
- 1.4 Zhvillimi i infrastrukturës
- 1.5 Përmirësimi i bujqësisë dhe zhvillimit rural

**QA2: Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të rinjve dhe depopullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara.**

**Prioritetet:**

- 2.1 Përmirësimi i kualitetit të arsimit dhe përshtatja e nevojave në pajtim me kërkesat e tregut të punës
- 2.2 Nxitja e bashkëpunimit mes arsimit dhe Biznes sektori
- 2.3 Parandalimi i largimit të profesionistëve të rinj nga rajoni
- 2.4 Mundësi të barabarta për të gjithë në tregun e punës
- 2.5 Qasje e barabartë tek shërbimet për të gjithë qytetarët në rajon

**QA3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP**

**Prioritetet:**

- 3.1 Përmirësimi i qasjes dhe rregullimi i lokaliteteve turistike
- 3.2 Tejkalmi i karakterit sezonal të turizmit në rajon
- 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative -rurale të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike
- 3.4 Përmirësimi i menaxhimit me destinacionet turistike
- 3.5 Mbrojtja e ambientit jetësor
- 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë

#### **4. PRIORETIZIMI**

Projektet që do të realizohen gjatë vitit 2023 janë paraqitur në mënyrë tabelore (tabela 1), sipas qëllimeve strategjike, prioriteteve dhe masave nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026. Nga tabela e pasqyruar mund të shihet se numri i përgjithshëm i aktiviteteve projektuese të planifikuara është 55, nga të cilat për Qëllimin strategjik 1 janë planifikuar 23 aktivitete projektuese për realizim ose 41,82% nga numri i përgjithshëm. Për Qëllimin strategjik 2 janë planifikuar 4 aktivitete projektuese ose 7,27%, ndërsa për Qëllimin strategjik 3 janë planifikuar 28 aktivitete projektuese ose 50,91% nga numri i përgjithshëm. Mund të përfundohet se numri më i madh i aktiviteteve projektuese janë planifikuar për Qëllimin strategjik 3, pastaj vijon Qëllimi strategjik 1 dhe më së paku aktivitete projektuese janë prioritetuar për Qëllimin strategjik 2. Aktivitetet projektuese që janë paraqitur do të realizohen nga ana e Qendrës për zhvillim të RPJP, komunave në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor dhe ndërmarrjeve publike komunale.

Është me rëndësi të theksohet se palët e tjera të interesuara, siç është sektori privat realizojnë projekte (psh. të financuara përmes IPARD, FIZHT dhe të ngjashme), por vështirë se shpërndajnë informacione duke përfshirë edhe mjetet financiare, ndërsa sektori civil gjeneron ide për projekte,

por ka vështirësi në sigurimin e mjeteve financiare për përgatitjen dhe kofinancimin e vetë projekteve.

## **5. PLANI FINANCIAR I QËLLIMEVE, PRIORITETEVE DHE MASAVE STRATEGJIKE**

Në Planin aksionar që është paraqitur në mënyrë tabelore janë paraqitur të dhëna për shumën e mjeteve financiare me të cilat do të realizohen aktivitetet e projekteve. Gjithashtu janë paraqitur edhe burimet e financimit, programet e financimit nga buxheti nacional si dhe partnerët në realizimin e aktiviteteve të projekteve. Shuma e përgjithshme e mjeteve për realizimin e aktiviteteve të projekteve është 230.503.327 DEN. Për Qëllimin strategjik 1 janë planifikuar 75.913.666 DEN ose 32,93%, për Qëllimin strategjik 2 26.195.070 DEN ose 11,36%, dhe për Qëllimin strategjik 3 janë planifikuar 128.394.591 DEN ose 55,71%. Nga të dhënat numerike të paraqitura është e dukshme që shumën më të madhe të mjeteve është e planifikuar për aktivitetet sipas Qëllimit strategjik 3, pastaj vjen Qëllimi strategjik 1 dhe më pak mjete janë planifikuar për Qëllimin strategjik 2.

## **6. MODELET E INTER-AKSIONIT MES AKTORËVE NË REALIZIMIN E PROGRAMIT**

Realizimi i Programit, përmasa masave dhe aktiviteteve, duhet të kontribuojë në përmirësimin e kualitetit të jetës së popullatës në rajonin planor Jugperëndimor. Ajo nënkupton përmirësimin e infrastrukturës, krijimin e kushteve për hapjen e bizneseve të reja, ngritjen e mundësive ekonomike të popullatës, zvogëlimin e shpërnguljes nga zonat rurale në ato urbane, dhe nga zonat urbane jashtë shtetit. Zhvillimi i barabartë rajonal në tërësi duhet të ndihet në komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor, përmes zhvillimit të tyre të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror.

Partnerët veçanërisht përfaqësuesit e komunave nga rajoni janë vazhdimisht në mënyrë aktive të kyçur në realizimin e Programit veçanërisht gjatë realizimit të aktiviteteve projektuese. Gjithashtu të gjithë partnerët dhe palët e interesuara nga rajoni janë përfshirë në proces nga fillimi me atë që nëpërmjet seioneve të forumeve i identifikojnë problemet dhe nevojat dhe propozojnë zgjidhje përmes aktiviteteve të projekteve të cilat janë në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Komunat në territorin e të cilave po realizohen aktivitetet projektuese, çdoherë kanë përfaqësues që janë pjesë e ekipit projektues, dhe japin kontributin e tyre nga fillimi i aktiviteteve (futjen në punë të operatorëve ekonomik) dhe deri në përfundim me çka bëhet pranimi teknik dhe nënshkruhen procesverbalet.

Kur janë në pyetje ndërtimet komunat e sigurojnë organin mbikëqyrës dhe me atë janë faktorë kryesor gjatë realizimit të atij lloji të aktiviteteve.

Kur realizohen aktivitete të llojit të shërbimeve për përgatitjen e dokumentacionit teknik atëherë komunat e përgatisin pjesën e detyrës projektuese për territorin e tyre por edhe gjatë përpunimit ato në vazhdimësi janë të përfshirë dhe aktivë.

Në këtë mënyrë me këtë lloj bashkëveprimi me partnerët sigurohet ndikim pozitiv në zhvillimin e komunave dhe ajo reflektohet edhe në zhvillimin e përgjithshëm të rajonit Jugperëndimor dhe të shtetit. Programi paraqet bazë për bashkëpunim ndër-komunal më dinamik, përmirësimin e relacioneve të tyre me rrethinën dhe bashkëpunimin me rajonet e tjera. Me përfshirjen e të gjitha kapaciteteve të disponueshme në nivel rajonal duhet të arrihet deri te zvogëlimi i dallimeve sociale të komunave, rajonit në tërësi, si dhe mes mjediseve urbane dhe rurale.

## **7. MËNYRA E INFORMIMIT TË PUBLIKUT**

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për të gjitha aktivitetet rregullisht e informon publikun përmes UEB faqes së saj [www.southwestregion.mk](http://www.southwestregion.mk). Gjithashtu edhe përmes FB profilit të Qendrës rregullisht jepen informacione për aktivitetet e Qendrës, dhe për aktivitetet e komunave në kuadër të rajonit. Profili i FB shfrytëzohet edhe për komunikim të rregullt me Biznes sektorin ku shkëmbehen informacione për mundësitë e financimit, për ndihmë teknike gjatë përgatitjes së aplikacioneve dhe sigurimit të mentorëve. Në profilin e FB të Qendrës shpërndahen edhe informacione në formë të historive të suksesit të bizneseve nga rajoni të cilat kanë për qëllim t'i nxisin edhe të tjerët e veçanërisht të rinjtë dhe gratë nga rajoni të fillojnë bizneset e tyre. Gjithashtu Qendra ka edhe kanalën e saj në Youtube në të cilin i shpërndan informacionet në formatin video, siç janë deklaratat, prezantimet, historitë e bizneseve të suksesshme dhe të ngjashme.

Përveç kësaj, Qendra të gjitha informacionet e rëndësishme i shpërndan me partnerët edhe përmes postës elektronike, organizimin e info takimeve, dhe me takime të përbashkëta me palët e interesuara. Gjithashtu për informimin e publikut shfrytëzohen edhe mediumet lokale, rajonale dhe nacionale në formë të shkruar dhe elektronike. Qendra i kushton kujdes të veçantë prezantimit të aktiviteteve të saja në mënyrë sa më transparente, me çka do të mundësojë përfshirjen e një numri më të madh të pjesëmarrësve nga rajoni në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

## **8. ANALIZA E RREZIKUT**

Në periudhën e kaluar e gjitha bota po ballafaqohet me pandeminë nga COVID 19 por edhe pse në vitin 2022 llogaritet se pandemia është qetësuar gjithsesi për disa aktivitete grupore të caktuara Qendra ende mban llogari për disa masa të caktuara për mbrojtje. Nëse gjatë periudhës dimërore



numri i të infektuarve përsëri rritet do të shfrytëzohen forma/aktivitete alternative në pajtim me protokollet e lëshuara nga Ministria e shëndetësisë, por ajo do të kufizojë mundësitë për realizimi të tërësishëm të planifikimeve.

Këtë vit dhe sipas prognozave edhe vitin tjetër bota po ballafaqohet me krizë energjetike dhe ekonomike. Veçanërisht është shumë i rëndësishëm inflacioni i cili kontribuon në një kohë të gjatë në rritjen e çmimeve në të gjitha nivelet. Rritja e çmimit të shërbimeve, stoqeve, punëve dhe materialeve mund të ketë ndikim negativ mbi realizimin e projekteve rajonale. Në realizimin e aktiviteteve të caktuara veçanërisht gjatë realizimit të projekteve që janë aplikuar para një kohe më të gjatë mund të ballafaqohemi me mungesë të mjeteve për shkak të dallimeve mes çmimeve të planifikuara dhe atyre aktuale.

Gjithashtu ndikim negativ mund të ketë edhe gjendja politike në shtet sepse mund të sjellë deri te zvarritja e miratimit të vendimeve të rëndësishme të cilat janë të një rëndësie të madhe për punën dhe funksionimin e të gjithë aktorëve të cilët shfrytëzojnë mjete buxhetore dhe nga donatorë.

Si rrezik për realizimin e Programit, mund të llogariten edhe fatkeqësitë kohore ose katastrofat natyrore të cilat janë të paparashikueshme, dhe mundet në masë të madhe ta prishin procesin e realizimit të aktiviteteve të projektit.

Realizimi i Programit mund të ketë efekt të zvogëluar nëse nuk sigurohen mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e aktiviteteve të projektit.

Tabela 1

<b>Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural</b>							
<b>Prioriteti 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve të brendshme dhe jashtme të financimit të NVM	Biznes Qendër për përkrahje dhe shërbime për sektorin e biznesit	1.Veprimi si zyrë rajonale kontakti për FIZHT 2.Përkrahje teknike dhe informim të Biznes sektorit për thirrjet aktive 3.Programi i vauçerëve për ndërtimin e kapaciteteve të Biznes sektorit 4.Shpallja e listës së burimeve të mundshme të financimit qeveritare dhe të tjera për Biznes sektorin 5. Informimi i bizneseve të udhëhequra nga gratë për mundësitë e veçanta të financimit	12 muaj	360.000	1.Mjete të shfrytëzuara nga burime të brendshme dhe të jashtme të financimit 2.Numri i bizneseve të reja start-up të filluara 3.Numri i NVM të themeluara dhe të udhëhequra nga gratë shfrytëzues të burimeve të brendshme dhe të jashtme të financimit të NVM	KZHRPJP, QZHRPJP, NJVL, NVM, FIZHT, MVL, SDC
<b>Prioriteti 1.2 Përforcimi dhe modernizimi i sektorit të NVM</b>							
1.2.4	Nxitja e shkëmbimit të përvojave dhe njohurive mes subjekteve nga vendi dhe jashtë	Biznes Qendër për përkrahje dhe shërbime për sektorin e biznesit	1.Promovimi i sipërmarrësve të sukseshëm nga rajoni/ Intervista me sipërmarrës për shpërndarjen e historive të suksesit/ përgatitja e video klipëve të promovuara në rrjetet sociale 2.Nxitja dhe vendosja e bashkëpunimit me Odat ekonomike, akseleratorë, universitetet	12 muaj	120.000	1.Shitja e realizuar e produkteve tradicionale 2.Numri i të punësuarve në kompanitë e përkrahura (burra/gra) 3.Numri i kompanive që kanë siguruar financa nga programe të ndryshme 4. Numri i NVM të themeluara dhe të udhëhequra nga gratë të cilat kanë siguruar financim nga programe të ndryshme	QZHRPJP, NJVL, Biznes sektori, MVL, SDC

**Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural**

**Prioriteti 1.3 Rritja e investimeve në rajon**

Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
1.3.2	Nxjtja e takimeve të biznes sektorit me investitorët potencial	Biznes Qendër për përkrahje dhe shërbime për sektorin e biznesit	1.Promovimi i Biznes Qendrës në rrjetet sociale, shpallje të rregullta të informacioneve në FB me informacione të nevojshme për kompanitë, shpallja e video materialeve në kanalën Youtube të QZHRPJP	12 muaj	100.000	1.Numri i shpalljeve 2.Numri i reaksioneve/pëlqimeve 3.Numri i komenteve	QZHRPJP, NJVL, Biznes sektori, MVL, SDC

**Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës**

1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Zhvillimi i infrastrukturës publike në zonat rurale, Investime në infrastrukturën lokale rrugore	Ndërtimi i rrugëve qasëse deri te tokat bujqësore në RPJP	6 muaj	6.000.000	1.Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të infrastrukturës rrugore 3.Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të ndërtuar	QZHRPJP, MBPU Prog.Sub.Kap. Për zhvillim të RP Komunitat e Debërcës, M.Brod dhe Ohrit
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Përkrahje të zhvillimit ekonomik lokale përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive tjera ekonomike	Rikonstruktimi i rrugëve për këmbësorë Goce Dellçev dhe rr.Dimitar Vllahov në pjesën e vjetër të qytetit të Strugës	3 muaj	2.210.286	1.Gjatësia e rrugëve 2.Numri i personave shfrytëzues (burra/gra) 3.Numri i personave (burra/gra) që kanë qasje më të mirë deri te arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale si rezultat i rrjetit rrugor të ndërtuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR (Programi për ZHBR 2021-2022)

**Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural**

**Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës**

Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Rikonstruktimi dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gorenc	Rikonstruktimi dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gorenc – Komuna e Debërcës	6 muaj	2.615.598	1.Gjatësia e rrugës 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të infrastrukturës rrugore 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të ndërtuar	Komuna e Debërcës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën e Vevçanit	Rikonstruktimi/ndërtimi i rrugëve në Komunën e Vevçanit	6 muaj	2.150.782	1.Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të rrugëve të ndërtuara 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të ndërtuar	Komuna e Vevçanit, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Rikonstruktimi i rrugës nga Qendër Zhupa deri te Ilishka Krasta	Rikonstruktimi i rrugës në Komunën e Qendër Zhupës	6 muaj	3.600.000	1.Gjatësia e rrugës 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të rikonstruktuar	Komuna e Qendër Zhupës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)

**Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural**

**Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës**

Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Përmirësimi i infrastrukturës publike në Komunën e Ohrit përmes rikonstruktimit të rrugës “Marko Cepenkov”	Rikonstruktimi i rrugës në Komunën e Ohrit	6 muaj	6.200.000	1.Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të rrugës 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të rikonstruktuar	Komuna e Ohrit, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i zonave urbane)
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Rikonstruktimi i rrugës “Rraim Lika”	Rikonstruktimi i rrugës në Komunën e Kërçovës	6 muaj	9.121.916	1. Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale si rezultat i rrjetit rrugor të rikonstruktuar	Komuna e Kërçovës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i zonave urbane)
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Ndërtimi/ rikonstruktimi i rrugëve në mjediset rurale në rajon	Ndërtimi/riikonstruktimi i rrugëve për lidhjen e vendbanimeve në rajon	8 muaj	23.600.000	1. Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të infrastrukturës rrugore 3. Numri i personave (burra/gra) të cilët kanë qasje më të mirë deri në arsim, shëndetësi dhe	QZHRPJP, NJVL, APFBZHR, Programi për Zhvillim rural

						mbrojtje sociale si rezultat i rrejtet rrugor të ndërtuar	
<b>Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural</b>							
<b>Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
1.4.3	Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale në rajon	Ndërtimi i rrejtet sekondar për kanalizim fekal në f.Veleshtë dhe lidhja e saj me kolektorin transit për kanalizim fekal	Ndërtimi i rrejtet sekondar për kanalizim fekal në f.Veleshtë – Komuna e Strugës	6 muaj	5.899.096	1.Gjatësia e sistemeve të ndërtuara dhe rikonstruktura të kanalizimit 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të sistemeve të kanalizimit	Komuna e Strugës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë	Përgatitja e projektit themelor për ndërtimin e murit mbrojtës në f.Kollar	Përgatitja e dokumentacionit teknik – projekt themelor për ndërtimin e murit mbrojtës në f.Kollar – Komuna e Kërçovës	6 muaj	707.657	1.Gjatësia e infrastrukturës për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të mureve mbrojtëse	Komuna e Kërçovës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë	Përpunimi i dokumentacionit teknik-projektues për rrugë nga f.Leskoec deri në f.Lakoçerej i Epërm dhe f.Lakoçerej i Poshtëm	Përgatitja e dokumentacionit teknik për rrugë f.Leskoec-f.Lakoçerej i Epërm dhe f.Lakoçerej i Poshtëm – Komuna e Ohrit	6 muaj	2.362.593	1. Gjatësia e infrastrukturës për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues	Komuna e Ohrit, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë	Projekt themelor për ndërtesë infrastrukturore për rikonstruktimin e rrugës në v.b.Lisiçan	Përgatitja e dokumentacionit teknik - projekt themelor për rikonstruktimin e rrugës në v.b.Lisiçan – Komuna e Pllasnicës	6 muaj	2.165.738	1. Gjatësia e infrastrukturës për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të rrugës	Komuna e Pllasnicës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i fshatrave)
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë	Projekt themelor për rikonstruktimin e rrugës lokale qasëse nga kryqëzimi me rrugën lokale Dibër-	Përgatitja e dokumentacionit teknik për rikonstruktimin e rrugës lokale f.Bomovë	6 muaj	6.500.000	1. Gjatësia e infrastrukturës për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik	Komuna e Dibrës, MVL, BZHR (Programi ZHBR 2022-2023/zhvillimi i krahinave me

		f.Bomovë deri në f.Sushicë	deri në f.Sushicë – Komuna e Dibrës			2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të rrugës	nevoja të veçanta zhvillimore)
<b>Qëllimi afatmesëm 1: Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural</b>							
<b>Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë	Projekt themelor për infrastrukturë lineare – ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve dhe krahëve në Komunën e Pllasnicës	Përgatitja e dokumentacionit teknik – projekt themelor për infrastrukturë lineare – ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve dhe krahëve (nr.tek. 07/22) – ndërtimi dhe rikonstruktimi i një pjese të pr7 dhe pr12 me krahët e tyre	6 muaj	2.200.000	1. Gjatësia e infrastrukturës për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 2.Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të rrugëve dhe krahëve të rrugëve	Komuna e Pllasnicës, MVL, BZHR (Programi për ZHBR 2022-2023/ zhvillimi i krahinave me nevoja të veçanta zhvillimore)

<b>Qëllimi afatmesëm 2: Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara.</b>							
<b>Prioriteti 2.5 Qasje e barabartë tek shërbimet për të gjithë qytetarët e rajonit</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
2.5.1	Ngritja e kualitetit të shërbimeve sociale dhe qasje për të gjithë kategoritë e qytetarëve	Organizimi i forumeve rajonale	Organizimi i 2 forumeve për Programin për ZHBR të MVL/BZHR	8 muaj	268.000	1.Numri i pjesëmarrësve (burra/gra) në forume 2.Numri i projekt ideve të gjeneruara të cilat i përshtaten edhe burrave edhe grave 3.Numri i koncepteve të përgatitura	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, SDC, BZHR, Njësia projektuese ZHBRQI
2.5.1	Ngritja e kualitetit të shërbimeve sociale dhe qasje për të gjithë kategoritë e qytetarëve	Projekt investues me elemente të përfshirjes sociale dhe digjitalizimit	Punë infrastrukturore, përfshirje sociale dhe digjitalizim	24 muaj	24.298.325	1.Numri i shfrytëzuesve të infrastrukturës së ndërtuar/rikonstruktuar 2.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) nga kategoritë e rrezikuara	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, SDC, Njësia projektuese ZHBRQI
2.5.5	Krijimi i kushteve për pranimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimin e BRE	Rikonstruktimi i kuzhinës në IPKF “Planinski cvet” në Vevçan	8 muaj	1.628.745	1.Numri i fëmijëve (meshkuj/femra) që i shfrytëzojnë objektet ë nivel vjetor 2.Sipërfaqja e objekteve të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR(Programi ZHBR 2022-2023/ zhvillimi i rajoneve planore )



<b>Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>							
<b>Prioriteti 3.1 Përmirësimi i gasjes dhe rregullimi i lokaliteteve turistike</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
3.1.3	Infrastrukturë rrugore deri te lokalitetet turistike të përshtatura për personat me nevoja të veçanta	Zhvillimi i turizmit rural dhe veprimtarive tjera komplementare në RPJP	1.Ndërtimi i rrugës nga Papradniku i Vogël deri te Liqeni i Dibrës Komuna e Qendër Zhupës	10 muaj	6.202.364	1.Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) në nivel vjetor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR – Programi ZHBR 2022-2023/ zhvillimi i rajoneve planore)
3.1.3	Infrastrukturë rrugore deri te lokalitetet turistike të përshtatura për personat me nevoja të veçanta	Zhvillimi i turizmit rural dhe veprimtarive tjera komplementare në RPJP	2.Ndërtimi i rrugës PopojMllaka në Vevçan	10 muaj	5.135.906	1. Gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) në nivel vjetor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR – Programi ZHBR 2022-2023/ zhvillimi i rajoneve planore)
3.1.5	Revitalizimi i lokaliteteve të rëndësishme nga trashëgimia natyrore dhe kulturore	Rregullimi i hapësirës rekreative me pajisje urbane	Rregullimi i hapësirës rekreative dhe vendosja e pajisjeve në Komunën e Kërçovës	8 muaj	16.000.000	1.Sipërfaqja e hapësirës së rregulluar 2. Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të hapësirës së rregulluar në nivel vjetor	Komuna e Kërçovës, MVL, BZHR – Programi për ZHBR 2022-2023(krahinat me nevoja të veçanta zhvillimore)
<b>Prioriteti 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative -rurale të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
3.3.4	Zhvillimi dhe përmirësimi i agro-turizmit në rajon	PACT to ACT	1.Mapimi i potenciale për agro-turizëm 2.Zhvillimi i modelit transnacional të agro-turizmit	24 muaj	14.500.000	1.Numri i potencialeve të mapuara për agro-turizëm 2.Numri i rutave dhe numri i destinacioneve për tura agro-bioiversitet	QZHRPJP, institucione nga Italia, Greqia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Shqipëria,

			3.Krijimi i platformës transnacionale 4.Përcaktimi i rutave agro-bio si destinacione turistike 5.Përgatitja e materialit promovues			3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të shërbimeve agro-turistike në nivel vjetor	BE EURO-MED thirrje për Përmirësimi i qëndrueshmërisë së turizmit
<b>Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>							
<b>Prioriteti 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative -rurale të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
3.3.5	Zhvillimi i bizneseve lokale si përkrahje për aktivitetet turistike brenda rajonit	Zhvillimi i turizmit sportiv në Komunën e Ohrit – ndërtimi i terrenit për golf	Ndërtimi i terrenit për ushtrime për golf në kazermin e vjetër në territorin e Komunës së Ohrit	8 muaj	5.700.000	1. Sipërfaqja e terrenit të ndërtuar 2. Numri i personave shfrytëzues (burra/gra) të hapësirave të rregulluara në nivel vjetor	Komuna e Ohrit, MVL – Programi për tejkalimin e dispariteteve dhe konkurrencës
<b>Prioriteti 3.5 Mbrojtja e ambientit jetësor</b>							
3.5.5	Masa për mbrojtje nga ndotja e ujërave	Ndërtimi i kanalit Lloshtica për grumbullimin e ujërave atmosferik	Ndërtimi i kanalit Lloshtica për grumbullimin e ujërave atmosferik në Komunën e Makedonski Brodit	8 muaj	5.800.000	1.Gjatësia e kanaleve për bartjen e ujërave atmosferik të ndërtuara/rikonstruktura 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të sistemit të kanalizimit	Komuna e Makedonski Brodit, MVL – Programi për tejkalimin e dispariteteve dhe konkurrencës
3.5.5	Masa për mbrojtje nga ndotja e ujërave	Furnizimi i kamionit thithës me vakum për mirëmbajtjen e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në zonat rurale të Komunës së Strugës	Furnizimi i kamionit thithës me vakum për mirëmbajtjen e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Strugës	6 muaj	7.200.000	1.Numri i intervenimeve me shfrytëzimin e tankut në nivel vjetor 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të sistemeve të mirëmbajtura	Komuna e Strugës, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023 (zhvillimi i krahinave me nevoja të veçanta zhvillimore)
3.5.6	Masa për mbrojtje nga ndotja e tokës	Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes	Furnizimi i pajisjeve për NPK për Komunën e Ohrit (traktor, plug për borë, kripë hedhëse, kamion me	6 muaj	7.723.206	1.Numri i intervenimeve me shfrytëzimin e pajisjeve në nivel vjetor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023

		furnizimit të pajisjeve	kabinë të dyfishtë, traktor me kabinë dhe rimorkio)			2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të sistemeve të mirëmbajtura	(zhvillimi i rajoneve planore)
<b>Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
<b>Prioriteti 3.5 Mbrojtja e ambientit jetësor</b>							
3.5.6	Masa për mbrojtje nga ndotja e tokës	Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve	Furnizimi i pajisjeve për NPK për Komunën e Debërcës (pëzierës betoni, prerëse motorike, agregat, pompë, shpuarës, çekan gjuajtës, shpuarës elektrik)	6 muaj	200.000	1.Numri i intervenimeve me shfrytëzimin e pajisjeve në nivel vjetor 2. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues të sistemeve të mirëmbajtura	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023 (zhvillimi i rajoneve planore)
3.5.8	Masa për ballafaqimin me rreziqet nga fatkeqësitë elementare	Furnizimi i automjetit për terren për mbikëqyrjen e vendeve të gjuetisë dhe zjarreve eventuale në pyje	Furnizimi i automjetit për terren për mbikëqyrjen e vendeve të gjuetisë dhe zjarreve eventuale në pyje, për shoqatën e gjuetarëve “Eko-fazan” – Kërçovë	6 muaj	354.000	1.Numri i monitoring aktiviteteve në nivel vjetor 2.Numri i intervenimeve vjetore 3. Numri i personave (burra/gra) shfrytëzues	Shoqata e gjuetarëve Eko-fazan nga Komuna e Kërçovës, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023 (zhvillimi i krahinave me nevoja të veçanta zhvillimore)
<b>Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë</b>							
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Efikasitet energjetik dhe rikonstruktiv të SHF “Faik Konica”, shkolla rajonale në fshatin Baçishtë, Komuna e Kërçovës	8 muaj	11.920.465	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2.Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2021-2022 (zhvillimi i rajoneve planore)
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit	Përmirësimi i EE në objektet	Renovimi i objektit të zjarrfikësve e një rëndësie	8 muaj	4.629.548	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR,

	energjetik në objektet publike	publike dhe ulja e ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	rajonale me masa për efikasitet energjetik në Dibër			2.Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	Programi për ZHBR 2021-2022 (zhvillimi i rajoneve planore)
<b>Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/ Financues
<b>Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë</b>							
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i SHF Baftjar Banushi në Strugë	8 muaj	7.575.536	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2. Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra)	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i SHF SHën Klimenti i Ohrit në f.Morovishtë – Komuna e Strugës	8 muaj	5.749.233	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2. Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i SHF Said Najdeni në Dibër	8 muaj	6.439.087	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2. Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe	Furnizimi dhe montimi i sistemeve fotovoltaike në 6 objekte në Kërçovë	8 muaj	6.310.023	1.Kapaciteti i sistemeve FV të instaluara 2.Energjia elektrike e prodhuar në nivel vjetor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)

		shfrytëzimi i BRE				3.Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të sistemeve të instaluara	
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i ndërtesës së komunës së Debërcës	8 muaj	3.695.601	1. Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2. Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3. Numri i shfrytëzuesve (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)
<b>Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>							
Nr.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohë-zgjatja	Shuma	Treguesit	Partnerë/Financues
<b>Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë</b>							
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i SHF Junus Emre në v.b.Lisiçan – Komuna e Pllasnicës	8 muaj	7.245.829	1.Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2.Numri i masave të realizuara për përmirësimin e EE 3.Numri i personave shfrytëzues (burra/gra)	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP dhe shfrytëzimi i BRE	Rikonstruktimi i kuvendit të Komunës së Makedonski Brodit	8 muaj	6.013.793	1.Sipërfaqja e objektit të rikonstruktuar 2.Numri i masave të kryera për përmirësimin e EE 3.Numri i personave shfrytëzues (burra/gra) të objektit të rikonstruktuar	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR, Programi për ZHBR 2022-2023(zhvillimi i rajoneve planore)

Tabela 2

## Mjetet e nevojshme për realizim

Nr.	Qëllimi afatmesëm	Shuma në DEN	Shuma në EUR
1	<b>Avancimi i ekonomisë dhe barazisë gjinore përmes shfrytëzimit të përparësive krahasuese të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitet investues në NVM me teknologji, njohuri të reja dhe inovacione, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri të ambientit jetësor, bujqësisë dhe zhvillimit rural</b>	75.913.666	1.234.369
2	<b>Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të të rinjve dhe depopullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara.</b>	26.195.070	425.936
3	<b>Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP</b>	128.394.591	2.087.717
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>230.503.327</b>	<b>3.748.022</b>

Бр. 01-280/1

30.11 2022 год.

ОХРИД

Врз основа на член 22, точка 1, алинеја 3 и член 23, а во врска со член 30, точка 1, алинеја 2 од Законот за рамномерен регионален развој на РС Македонија (Службен весник на РСМ, бр.24/2021 и 174/2021), и врз основа на членот 2, точка 1, алинеја 3 од Деловникот за работа на Советот за развој на Југозападниот плански регион, Советот за развој, на својата седма седница, одржана на 30.11.2022 година, ја донесе следнава

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, alineja 3 dhe nenit 23, dhe në lidhje me nenin 30, paragrafi 1, alineja 2 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.24/2021 dhe 174/2022), dhe në bazë të nenit 2, paragrafi 1, alineja 3 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Këshilli për zhvillim, në mbledhjen e shtatë, të mbajtur në datë 30.11.2022, e solli këtë:

### ОДЛУКА

1. Се усвојува Акцискиот план за спроведување на Програмата за развој на Југозападниот плански регион за 2023 година.
2. Составен дел на оваа Одлука е Акцискиот план за спроведување на Програмата за развој на Југозападниот плански регион за 2023 година.
3. Оваа Одлука влегува во сила со денот на нејзиното усвојување.

### VENDIM

1. Miratohet Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2023.
3. Ky Vendim hynë në fuqi prej ditës që është miratuar.

СОВЕТ ЗА РАЗВОЈ НА ЈУГОЗАПАДЕН  
ПЛАНСКИ РЕГИОН  
Претседател  
д-р Рамис Мерко

KËSHILLI PËR ZHVILLIM  
TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR  
President,  
d-r Ramis Merko



Струга, 30.11.2022

Strugë, 30.11.2022